



Prishtinë, 29.01.2024
Kodi i ZRRE-së: VB_202_2024

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 9 dhe Nenit 26, paragrafit 1, nënparagrafit 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 25 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022),
- Metodologjinë e Planit të Integritetit (korrik 2023), të aprovuar nga Agjencia për Parandalim të Korrupsionit me Vendimin nr protokoli 1476/23, të datës 26 korrik 2023,

në seancën e mbajtur me datë 29 janar 2024 nxori këtë:

VENDIM

I. **MIRATOHET** Plani i Integritetit i Zyrës së Rregullatorit për Energji, për periudhën tri (3) vjeçare 2023-2026, i hartuar nga Grupi Punues, i caktuar me Vendimin Nr. VB_201_2023, të datës 01 dhjetor 2023.

II. Personi përgjegjës për monitorimin dhe zbatimin e Planit të Integritetit, i caktuar me vendimin VB_201_2023 do të vazhdoj monitorimin e Planit të Integritetit në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit.

Arsyetim

Ky vendim nxirret me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore të përcaktuara me Ligjin Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022), në raport me detyrimet e agjencive të pavarura (në këtë rast Zyrës së Rregullatorit për Energji), për miratimin e Planit të Integritetit për tri vitet e ardhshme.

Në kuadër të kësaj, sipas udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit të Metodologjisë për Planet e Integritetit, të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 29 janar 2024, Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, nxjerr vendim për miratimin e Planit të Integritetit, të hartuar nga grupi punues, i caktuar me Vendim Nr. VB_201_2023, datë 1 dhjetor 2023, të theksuar si në pikën 1 të dispozitivit të këtij Vendimi.

Me datë 09 janar 2024 Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK), në pajtim me Nenin 25 të Ligjit për parandalim të korrupsionit, ka kërkuar nga ZRRE që Plani i Integritetit të dorëzohet në APK deri më së voni me datë 26 janar 2024 në formë elektronike. ZRRE ka përgatitur Planin e Integritetit dhe i njëjti



me datë 26.01.2024 është përcejellur te APK-ja në formë elektronike. ZRRE ka marr disa udhëzime nga APK-ja, të cilat janë përfshirë në Plan të Integritetit dhe njëkohësisht ka informuar APK-së se Plani i Integritetit do të paraqitet për aprovim në Seancë Bordi, dhe i njëjti do t'i dorëzohet APK-së pas Aprovimit nga Bordi i ZRRE-së, duke marr parasysh se "titullar" i institucionit të ZRRE-së është Bordi dhe vendimet merren me shumicë votash.

Znj. Rexhaj sipas pikës 2 të dispozitivit të këtij vendimi, si person përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit, i cili monitoron procesin sipas planit të integritetit, zbatimin e masave të përmirësimit nga institucioni, përgatit treguesit për vlerësimin e efikasitetit dhe vlerësimin e rezultateve të masave të propozuara për përmirësimin e integritetit.

Nga ajo çfarë u theksua në arsyetim, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Bordi i Rregullatorit:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Artë Isufi, anëtare

Adnan Preniqi, anëtar

Vendimi iu dorëzohet:

- Anëtarëve të Grupit Punues: Ardiana Bokshi, Drita Haziri dhe Hysnije Rexhaj;
- Personit përgjegjës për monitorim dhe raportim të Planit të integritetit: Hysnije Rexhaj;
- Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



PLANI I INTEGRITETIT

2024 – 2026

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI

29 Janar 2024



Përmbajtja

Deklarata për Integritet	3
Hyrje.....	4
1. Qëllimi.....	5
2. Objektivat e planit të integritetit.....	6
3. Parimet e menaxhimit të integritetit	6
3.1 Liderhipi	6
3.2 Përfshirja e personelit	7
4. Procesi i zhvillimit të planit të integritetit.....	8
4.1 Fazat e zhvillimit të planit të integritetit	8
4.2 Metodologjia e vlerësimit të rrezikut.....	9
5. Monitorimi i zbatimit të planit të integritetit dhe raportimi.....	10
5.1 Rishikimi i Planit të Integritetit.....	11
6. Matrica e vlerësimit të rrezikut	12
6.1 Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut	13
7. Fushat e rrezikut	13
7.1 Fushat e përgjithshme të rrezikut	13
7.2 Fushat e veçanta të rrezikut.....	14
8. Hyrja në fuqi	15
Shtojca1	16
Shtojca 2.....	20



Deklarata për Integritet

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është institucion i pavarur e themeluar me ligjin 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë dhe gjithnjë është e përkushtuar dhe të palëkundur në angazhimin e saj për të mbajtur standardet më të larta të integritetit në çdo aspekt të aktivitetit të saj për sektorin e energjisë; energjetik në Kosovë.

Integriteti nuk është vetëm një vlerë thelbësore, *“Integriteti është parimi i të vepruarit vazhdimisht në përputhje me vlerat etike dhe profesionale”*

Integriteti është themeli mbi të cilin ne ndërtojmë një të ardhme të qëndrueshme dhe të përgjegjshme. Angazhimi ynë ndaj integritetit është parësor për të siguruar praktika të drejta, transparente dhe etike në rregullimin e sektorit të energjisë.

Ne angazhohemi për paanshmëri në funksionet tona rregullatore duke siguruar që të gjithë pjesëmarrësit e tregut të energjisë të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë.

Ne zotohemi të ofrojmë informacion të qartë, të qasshëm dhe në kohë për publikun, palët e interesit dhe pjesëmarrësit e tregut duke nxitur besimin në proceset tona rregullatore.

Ne përpiqemi të ruajmë standardet më të larta të profesionalizmit dhe të integritetit në të gjitha aspektet e përgjegjësisë tona rregullatore.

Ne krijojmë një mjedis që promovon konkurrencën dhe inkurajon inovacionin në sektorin e energjisë. Korniza ligjore mbështet zhvillimin e një tregu të fuqishëm, efikas dhe të qëndrueshëm të energjisë.

Ne jemi të përkushtuar që në vendimet tona të marrim parasysh implikimet financiare dhe sociale të operatorëve dhe konsumatorëve përkatësisht, duke synuar një ekuilibër midis mirëqenies sociale dhe funksionimit të operatorëve.

Ne angazhohemi aktivisht me palët e interesit, duke përfshirë pjesëmarrësit e industrisë, konsumatorët për të konsideruar perspektiva të ndryshme në proceset tona të vendimmarrjes.

Ne jemi të përkushtuar për përmirësim të vazhdueshëm të proceseve tona rregullatore. Vlerësimet dhe përmirësimet e rregullta të politikave, procedurave dhe teknologjive tona sigurojnë që ne të përshtatemi me dinamikën në zhvillim të tregut të energjisë dhe të ruajmë standardet më të larta etike.

Ne inkurajojmë të gjithë punonjësit dhe palët e interesit të raportojnë çdo shqetësim në lidhje me sjelljen joetike përmes mekanizmave tanë të vendosur të raportimit. Ne jemi të përkushtuar të hetojmë raportimet në mënyrë të plotë dhe të paanshme.

Duke përqafuar këto parime, ne synojmë të jemi një rregullator i besueshëm dhe efektiv, duke kontribuar në stabilitetin, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e sektorit të energjisë.

Ymer Fejzullahu
Kryesues i Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji



Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji si institucion i pavarur, në pajtim me Nenin 25 të Ligjit nr.08/I-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Metodologjine e Planit të Integritetit të miratuar nga Agjencia për Parandalim të Korrupsionit me Vendimin 1472/23, të datës 26.07.2023 harton këtë Plan të Integritetit me qëllim të identifikimit të proceseve të ndjeshme ndaj sjelljeve dhe veprimeve që mund të jenë korruptive.

Po ashtu, në pajtim me nenin 25 të ligjit të sipërcukur ku kërkohet të caktohet zyrtari përgjegjës për menaxhimin e përgatitjes dhe zbatimit të planit të integritetit, Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji me vendimin VB_2021_2023 të datës 01 dhjetor 2023 ka caktuar grupin punues për hartimin e këtij plani, e poashtu edhe zyrtarin përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të planit të integritetit.

Plani i integritetit është një grup strategjish, politikash dhe praktikash të dizajnuara për të siguruar dhe promovuar integritetin brenda institucionit. Integriteti në këtë kontekst i referohet cilësisë së të qenit i ndershëm, sjellje në përputhje me vlerat dhe parimet morale, integritetin institucional, përputhshmëri dhe qëndrueshmëri në veprime.

Plani i integritetit ka një rol të rëndësishëm dhe shërben për përmirësimin e një sistemi efektiv të menaxhimit të integritetit në institucion, forcimin e llogaridhënies publike dhe transparencës në institucion, forcimin e rezistencës institucionale ndaj çënimeve të integritetit, si dhe planifikimin e menaxhimit të rrezikut të integritetit.

Plani i integritetit është një mekanizëm i krijuar për të eliminuar rrethanat e shfaqjes së korrupsionit dhe të reduktojë rreziqet nga korrupsioni; veprimet jo-etike dhe jo profesionale në të gjitha fushat e veprimit të institucionit.

Gjatë hartimit të planit të integritetit, ZRRE ka vlerësuar masat e menaxhimit të rreziqeve në fushat të cilat për nga natyra janë më të çnueshme ndaj korrupsionit, si: prokurimi publik, menaxhimi i burimeve njerëzore (rekrutimi, punësimi, promovimi i punonjësve etj), nënshkrimi i kontratave të prokurimit për mallra dhe shërbime, mbledhja e të hyrave përmes taksave, menaxhimi i financave publike, lëshimi i autorizimeve, lëshimi i licencave, caktimi i tarifave, konsumatorët etj., veprimtari këto për të cilat kërkohet vendimmarrje për interesin publik.

Vlerësimi i masave aktuale për menaxhimin e rrezikut ndaj korrupsionit përbën hapin e parë drejt përmirësimit të cilësisë së punës brenda fushëveprimit të caktuar. Varësisht nga mënyra se si këto masa kanë qenë të suksesshme në praktikë, ZRRE-ja vlerëson intensitetin e rrezikut të korrupsionit në zonën e dhënë (intensiteti mund të jetë i ulët, i moderuar ose i lartë).



Hapi tjetër përfaqëson planifikimin dhe futjen e masave të reja të menaxhimit të rrezikut ndaj korrupsionit, gjë e cila varet nga intensiteti i rrezikut të vlerësuar ndaj korrupsionit; për shembull, në rastin e rrezikut të vlerësuar me intensitet të lartë, vendoset një afat kohor i menjëhershëm (pa vonesë) për futjen e masave të reja të menaxhimit të rrezikut ndaj korrupsionit, dhe për intensitetin e ulët të rrezikut, masat e duhura mund të zbatohen në një periudhë më të gjatë kohore.

Karakteristikë tjetër është se gjatë hartimit të planit të integritetit u është mundur të gjithë punonjësve brenda ZRRE-së të marrin pjesë në zhvillimin e tij, duke e qenë se punonjësit e dinë më së miri se si funksionon ZRRE-ja. Përmes njohurive dhe përvojës së tyre është caktuar mënyra më e mirë e mundshme e njohjes së intensitetit të rrezikut ndaj korrupsionit dhe parregullsive të tjera dhe në këtë mënyrë janë propozuar masa dhe aktivitete adekuate për reduktimin gjegjësisht eliminimin e tyre. Duke qenë pjesë e zhvillimit/hartimit të këtij plani, punonjësit nuk e shohin planin e integritetit si një dokument i cili i imponohet, por më tepër si dokument të tyre, zbatim i të cilit do të kontribuojë për një ambient më të mirë pune.

Plani përshkruan masat e bazuara në rrezik për arritjen e objektivave të insitucionit dhe forcimin e sundimit të ligjit, si dhe vlerat dhe standardet profesionale.

1. Qëllimi

Qëllimi i hartimit të Planit të Integritetit nga Zyra e Rregullatorit për Energji është të parandalojë korrupsionin, eliminojë masat e shfaqjes së korrupsionit, mashtrimin dhe sjelljen joetike dhe jo profesionale në të gjitha fushat, brenda ZRRE-së. Pra, në të përcaktohen masa konkrete për trajtimin e rreziqeve të integritetit dhe arritjen e objektivave strategjike dhe specifike të ZRRE-së.

Me këtë plan të integritetit vendosen të dhënat dhe afatet me të cilat ZRRE pretendon të arrin:

- Identifikim të proceseve të ndjeshme ndaj sjelljeve dhe veprimeve që mund të jenë korruptive;
- Sistem efektiv të menaxhimit të integritetit në institucion që synon respektim të kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- Llogaridhënie publike dhe transparencë;
- Rezistencë institucionale ndaj cenimeve të integritetit; si dhe
- Planifikim të menaxhimit të rrezikut ndaj integritetit në institucion.

Hartimi i Planit të Integritetit ka përfshirë një qasje sistematike për të siguruar që standardet etike të vendosen, komunikohen dhe mbështeten nga të gjithë punonjësit në ZRRE.



2. Objektivat e planit të integritetit

Objektivat e planit të integritetit vendosen me qëllim që të caktohen, komunikohen dhe mbështeten standardet etike brenda ZRRE-së. Plani është krijuar për të nxitur një kulturë integriteti, transparence dhe llogaridhënieje.

Për arritjen e këtyre synimeve gjatë hartimit të këtij plani kemi identifikuar tre objektiva kryesore:

- Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore e financiare dhe forcimi i kapaciteteve njerëzore në lidhje me etikën dhe integritetin;
- Rritja e transparencës;
- Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të dokumentacionit.

Me arritjen e këtyre objektivave plani i integritetit kontribuon në suksesin e përgjithshëm dhe qëndrueshmërinë e ZRRE-së duke promovuar një mjedis pune pozitiv dhe me etikë.

Objektiva specifike e këtij plani është edhe të ngrisë vetëdijen e punonjësve në lidhje me efektet shkatërruese të korrupsionit për të arritur gjendjen *“zero tolerance ndaj korrupsionit”*.

3. Parimet e menaxhimit të integritetit

3.1 Lidershipi

Zhvillimi i planit të integritetit është aspekt thelbësor i lidershipit, pasi që krijon një kornizë për sjelljen etike dhe përgjegjshmërinë brenda ZRRE-së. Janë disa parime dhe hapa kyç që duhen marrë parasysh kur përfshihet lidershipi në zhvillimin e këtij plani:

- demonstrimi i standardeve më të larta të integritetit në veprimet e lidershipit,
- përfshirja e palëve të interesit, artikulumit i qartë i vlerave dhe parimeve të ZRRE-së,
- komunikimi i qartë i pritshmërive në lidhje me sjelljen etike për të gjithë punonjësit e ZRRE-së,
- sigurimi i trajnimeve,
- krijimi i mekanizmave raportues,
- inkurajimi i një kulture transparente,
- llogaridhënia etj.

Duke përfshirë këto parime në zhvillimin dhe zbatimin e planit të integritetit, lidershipi mund të krijojë një kulturë besimi, llogaridhënieje dhe sjelljeje etike brenda ZRRE-së, me qëllimin përfundimtar krijimin e të gjithave kushteve të nevojshme për të pasur një administratë tërësisht transparente.



3.2 Përfshirja e personelit

Përfshirja e personelit në hartimin e planit të integritetit është thelbësore për nxitjen e një kulture të sjelljes etike, transparencës dhe pajtueshmërisë brenda ZRRE-së.

Përfitimet nga përfshirja e personelit janë në:

- Idetë për zhvillimin e programeve të trajnimit dhe orientimi i punonjësve edhe drejt politikave të integritetit dhe standardet etike të ZRRE-së.
- Krijimi i kanaleve të qëndrueshme të komunikimit për të informuar stafin rreth planit të integritetit, përditësimin e politikave dhe çdo ndryshim tjetër në organizim.
- Inputi i punonjësve në zhvillimin ose shqyrtimin e politikave dhe procedurave.
- Sigurimi i udhëzimeve për punonjësit në lidhje me sjelljen etike, mekanizmat e raportimit dhe pasojat për mospërputhje.
- Sigurimi që mekanizmi i sinjalizuesit do të jetë konfidencial dhe i qashtë për të gjithë punonjësit.
- Inkurajimi që punonjësit të raportojnë shqetësimet etike pa frikën e hakmarrjes.
- Komunikimi me punonjësit për masat e vendosura për të mbrojtur sinjalizuesit nga hakmarrja duke theksuar angazhimin e ZRRE-së për konfidencialitetin dhe mos-hakmarrjen.
- Promovimi i diversitetit dhe gjithëpërfshirjes brenda ZRRE-së, pasi që perspektivat diverse do të kontribuojnë në një kulturë të fortë etike.
- Trajtimi i barabartë për të gjithë punonjësit pavarësisht nga prejardhja, pozicioni i vendit të punës ose qëndrimi i tyre.
- Kryerja e anketave për të vlerësuar perceptimet e punonjësve për integritetin, auditimin e brendshëm, korrupsionin, etj.
- Krijimi i mekanizmave për punonjësit që të kenë qasje proaktive mbi planin e integritetit dhe të sugjerojnë përmirësime.
- Sigurimi që udhëheqësit e ZRRE-së të demonstrojnë përkushtimin ndaj sjelljes etike dhe të shërbejnë si model për punonjësit e ZRRE-së.
- Politikat brenda ZRRE-së të jenë të qashta për të gjithë punonjësit përmes platformave të ndryshme si dhe manualeve për punonjësit.
- Sigurimi që politikat të komunikohen në atë mënyrë që është lehtë e kuptueshme nga të gjithë punonjësit.
- Krijimi i shërbimeve mbështetëse për punonjësit që mund të përballen me situata sfiduese, duke ofruar udhëzime se si të qartësojnë çështje të caktuara.



- Zhvillimi i planit të qartë reagimi ndaj krizave që përfshin hapa për të adresuar krizat e lidhura me integritetin dhe paraqitja e këtij plani tek të gjithë punonjësit.

Prandaj duke përfshirë punonjësit në krijimin e Planit të Integritetit ZRRE-ja do të krijojë një kulturë etike në vendin e punës.

Përforsimi i vazhdueshëm i standareve etike dhe angazhimi proaktiv i punonjësve kontribuojnë në suksesin e përgjithshëm të planit të integritetit.

4. Procesi i hartimit të planit të integritetit

Procesi i hartimit/zhvillimit të planit të integritetit është sistematik dhe gjithpërfshirës për të vendosur dhe promovuar sjelljen etike brenda ZRRE-së. Ky proces përfshin vlerësimin e efektshmërisë së sistemit të menaxhimit të integritetit institucional, duke përfshirë cilësinë e rregullave, praktikave të personelit dhe të gjitha proceseve të tjera të operimit (menaxhimin, menaxhimin financiar, burimet njerëzore, prokurimin publik, menaxhimin e të dhënave, menaxhimin e pasurive/aseteve, lëshimin e autorizimeve, lëshimin e licencave, vendosjen e tarifave, zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve etj.). Ky proces zvogëlon rreziqet duke reduktuar mundësitë dhe rrethanat që këto incidente të ndodhin.

Plani i integritetit përbëhet nga:

- Regjistrimi i cënueshmërisë të identifikuar për të gjitha fushat e funksionimit të ZRRE-së;
- Përcaktimi i masave për përmirësimin e integritetit që duhet të zbatohen për të zvogëluar cënueshmërinë e integritetit, si dhe afatin kohor dhe përgjegjësit për zbatimin e masave.

Gjatë hartimit të planit të integritetit bëhet vlerësimi i cënueshmërisë së integritetit për të gjitha fushat e funksionimit të ZRRE-së. Gjatë këtij procesi të gjithë punonjësit kanë pasur mundësi të marrin pjesë në vlerësimin e rrezikut të fushave të funksionimit të ZRRE-së dhe të propozojnë masa për të përmirësuar integritetin dhe cilësinë e përgjithshme të menaxhimit si dhe ofrimin e shërbimeve për palët e interesit.

4.1 Fazat e zhvillimit të planit të integritetit

Gjatë hartimit të planit të integritetit, zbatohen disa faza zhvillimi, siç janë:

- Faza përgatitore – në këtë fazë drejtuesi/personi përgjegjës i ZRRE-së nxjerr vendim për themelimin e grupit punues dhe emërimin e koordinatorsit për hartimin e planit të integritetit; mbledhjen e informacioneve të nevojshme për zhvillimin e planit të integritetit si dhe njoftimin e të gjithë punonjësve për rëndësinë e planit të integritetit.



- **Faza e vlerësimit të rrezikut të integritetit** – gjatë kësaj faze koordinatori së bashku me grupin punues analizojnë dokumentacionin e mbledhur (legjislacionin dhe rregulloret e brendshme të zbatueshme në punën e administrimit të ZRRE-së, përshkrimet e punës dhe fushëveprimin e secilit departament të ZRRE-së) si dhe çdo proces të vendimmarrjes dhe ofrimin e shërbimeve. Bazuar në gjendjen aktuale përcaktohen fushat e rrezikut si dhe identifikohen dhe vlerësohen rreziqet.
- **Faza e propozimit të masave për përmirësimin e integritetit** – kjo fazë përfshin përcaktimin e prioriteteve për intervenim, dhe propozimin e masave për zvogëlimin e rreziqeve dhe përgjegjësit për zbatim.
- **Faza e monitorimit dhe raportimit të planit të integritetit** – përfshin monitorimin, vëzhgimin dhe regjistrimin e rregullt të aktiviteteve që ndodhin në një plan të integritetit dhe procesin e mbledhjes së informacionit për të gjitha aspektet e zbatimit të planit të integritetit. Ndërsa raportimi mundëson që informacionet e mbledhura të përdoren në marrjen e vendimeve për përmirësimin e zbatimit të planit të integritetit.

Pra, hartimi i këtij plani të integritetit ka kaluar disa hapa dhe ka përfshirë angazhimin e menaxhmentit, krijimin e grupit punues, analizimin e rreziqeve, pajtueshmërinë me legjislacionin, zhvillimin e politikave dhe akteve të brendshme, strategjinë e komunikimit, trajnimin, mekanizmin e sinjalizimit, monitorimin dhe auditimin, përmirësimin e vazhdueshëm, komunikimin e jashtëm, dokumentimin dhe raportimin.

Duke ndjekur këta hapa, ZRRE-ja ka zhvilluar një plan gjithëpërfshirës të integritetit që promovon një kulturë të sjelljes etike dhe të llogaridhënies. Monitorimi, trajnimi dhe komunikimi i rregullt janë thelbësor për suksesin e vazhdueshëm të planit.

4.2 Metodologjia e vlerësimit të rrezikut

Për hartimin e planit të integritetit si dhe për të analizuar dhe vlerësuar integritetin dhe sjelljet joetike në ZRRE, grupi punues ka përdorur dy metoda kryesore: *metoden cilësore* dhe *metodën sasiore*.

Në fillim është kryer analiza e e akteve të brendshme dhe strategjia për Zyrën e Rregullatorit për Energji për të parë nëse janë të parashikuara rregullat për etikën dhe integritetin e punonjësve të institucionit. Ndër dokumentet që janë shqyrtuar janë Manuali i Operimeve, Kodi i Etikës, Rregulla për Organizimin dhe Funkcionimin e ZRRE-së, përshkrimet e punës, rregulloret e menaxhimit financiar etj.



Më pas janë analizuar të dhënat që janë nxjerrë nga diskutimet me stafin e ZRRE-së, diskutime që kanë shërbyer për të identifikimin e problematikave të hasura gjatë proceseve të ndryshme të punës, të cilat kanë probabilitet të lartë për të pasur shkelje të integritetit apo sjellje jo-etike.

Për të matur perceptimin e stafit të ZRRE-së mbi çështje të etikës dhe integritetit është hartuar një pyetësor, i cili u është vënë në dispozicion të gjithë punonjësve. Punonjësit janë përgjigjur në mënyrë anonime pyetësorit. Pyetësori ka përfshirë fusha të ndryshme si: aspektet organizative, ndarjen e funksioneve, proceset e menaxhimi dhe zhvillimit të burimeve njerëzore, auditimin e brendshëm, mekanizmin e ankesave, raportimin e korrupsionit, kulturën organizative, qeshtjet e etikës brenda institucionit, integritetin, konfliktin e interesit, komunikimin, informacionin etj.

Nga të gjënat e përgjigjeve në pyetësor, mund të themi se shumica e punonjësve të ZRRE-së kanë përvojë relativisht të gjatë pune në institucion (mbi 10 vite).

Nga analiza sasiore punonjësit kryesisht janë të informuar me legjislacionin në fuqi sa i përket kodit të etikës, përgjegjësi ndaj punës që kryejnë, dhuratave, konfliktin e interesit, të dhënave konfidenciale, etj.

Nga analiza cilësore e dokumentacionit të ZRRE-së, konstatohet se aktet e brendshme për çështjet që lidhen me etikën, sinjalizimin, transparencën etj., janë të plota çka mbështetet edhe nga analiza sasiore. Punonjësit pjesërisht janë në dijeni se institucioni ka rregullore të veçantë që adreson aktivitetet e natyrës korruptive apo sjelljet jo-etike dhe njohin këtë rregullore. Gjithashtu, punonjësit e njohin strukturën se ku duhet të raportojnë në rastet e konfliktit të interesit.

5. Monitorimi i zbatimit të planit të integritetit dhe raportimi

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK) ka mandat ligjor për monitorim dhe mbikëqyrje të zbatimit të Planit të Integritetit dhe nga kontrolli i drejtpërdrejtë mund të zhvilloj procedurën e hetimit administrativ të raporteve për zbatimin e planeve të integritetit të cilat ZRRE do t'i dorëzojë Agjencisë dhe si rezultat mund do të japë opinione/rekomandime për parandalimin e korrupsionit dhe formave tjera të cenimit të integritetit.

Sipas pikës 12 të Metodologjisë (të aprovuar nga APK), ZRRE përgatit dhe paraqet në APK Raportin Vjetor për zbatimin e Planit të Integritetit për vitin paraprak deri me 31 janar të vitit vijues.

Monitorimi i planit të integritetit përfshin mbikëqyrjen dhe vlerësimin sistematik të zbatimit të masave të dizajnuara për të siguruar sjelljen etike, transparencën dhe pajtueshmërinë brenda ZRRE-së. Qasja sistematike për monitorimin e planit të hartuar të integritetit përfshinë:

- Identifikimin e treguesve të veçantë që masin efektivitetin e planit të integritetit;



- Treguesit kryesorë të performancës ku përfshihet numri i shkeljeve etike të raportuara, ndjekja e trajnimeve në lidhje me etikën etj.
- Sigurimin që auditimet të jenë gjithëpërfshirëse duke mbuluar aspekte të ndryshme të planit të integritetit siç janë praktikat financiare, procedurat e prokurimit dhe sjellja e punonjësve;
- Mbajtjen e një mekanizimi efektiv dhe konfidencial në lidhje me sinjalizuesit;
- Shqyrtimin e rregullt të raporteve të dorëzuara dhe hetimin e menjëherëshëm të çdo shkeljeje ose edhe shkeljeje të supozuar;
- Zbatimin e programeve të vazhdueshme të trajnimit për të edukuar punonjësit në lidhje me standardet etike, kërkesat e pajtueshmërisë dhe rëndësinë e integritetit;
- Monitorimin e pjesëmarrjes në trajnime dhe vlerësimin e efektivitetit të këtyre trajnimeve;
- Mbajtjen e shënimeve të detajuara të aktiviteteve që lidhen me planin e integritetit, duke përfshirë seancat e trajnimit, gjetjet e auditimit dhe veprimet për t'i adresuar ato;
- Mbledhjen e informatave të nevojshme nga palët e interesit për të vlerësuar integritetin e përceptuar të ZRRE-së;
- Përdorimin e anketave/pyetësorëve, fokus grupeve ose mekanizmave të tjerë për të kuptuar perspektivat e palëve të interesit mbi praktikat etike të ZRRE-së;
- Kryerjen e kontroleve të vazhdueshme për të verifikuar përputhjen me kërkesat ligjore;
- Zbatimin e veprimeve korigjuese për të adresuar dobësitë dhe boshllëqet e identifikuar në kornizën e integritetit;
- Përdorimin e rezultateve të monitorimit për të identifikuar fushat për përmirësim të këtij plani.
- Përditësimin dhe përmirësimin e rregullt të planit bazuar në mësimet e nxjerra, rreziqet e paraqitura dhe ndryshimet në organizim;
- Sigurimin e transparencës në raportim për të krijuar besim dhe për të demonstruar përkushtimin e ZRRE-së ndaj sjelljes etike.

Duke zbatuar sistematikisht këta hapa monitorimi, ZRRE-ja do të forcojë integritetin dhe do të nxisë një kulturë etike dhe të pajtueshmërisë dhe zbutjen e rreziqeve që lidhen me sjelljen joetike.

5.1 Rishikimi i Planit të Integritetit

Plani i Integritetit vlenë për periudhën tri (3) vjeçare 2024-2026 dhe rishikohet çdo vit, me mundësi përditësimi nga ZRRE-ja, në përputhje me Neni 25 paragrafin 5 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Metodologjinë e Planit të Integritetit, aprovuar nga APK me Vendimin 1476/23, dt 26.07.2023. Gjatë rishikimit të Planit të Integritetit do të merren konsideratë rezultatet e zbatimit të masave të propozuara për reduktimin e rrezikut.



6. Matrica e vlerësimit të rrezikut

Matrica e vlerësimit të rrezikut është një mjet që përdoret për të vlerësuar dhe për të prioritzuar rreziqet e mundshme bazuar në gjasat dhe ndikimin e tyre. Matrica zakonisht përbëhet nga një rrjetë me GJASË në njërin bosht dhe NDIKIM në boshtin tjetër.

Çdo kombinim i gjasës me ndikimin shoqërohet më pas me një vlerësim ose nivel rreziku. Në këtë mënyrë më lehtë caktohen çështjet me prioritet dhe ndërmerren veprimet, masat aty ku është e nevojshme për të mbajtur fushën apo aktivitetin në të njëjtin rrugë.

Figura 1. Matrica e vlerësimit të rrezikut

Pasoja/Ndikimi	Madhor	10																			
		9																			
		8																			
	Mesatar	7																			
		6																			
		5																			
		4																			
	Vogël	3																			
		2																			
		1																			
Intensiteti i rrezikut (gjasat x ndikimi)		Ulët			Mesatar							Lartë									
		Probabiliteti/Gjasat																			

Intensiteti i rrezikut fitohet duke shumëzuar probabilitetin/gjasën me pasojën/ndikimin, duke përdorur matricën e rrezikut, “ndikimi (1-10) x pasoja (1-10)”, treguar si në figurën më lartë.

Shembull i vlerësimit të rrezikut nga matrica:

a) PASOJA ose NDIKIMI vlerësohet me 7

b) PROBABILITETI ose GJASAT vlerësohet me 5

VLERËSIMI: $a \times b = 7 \times 5 = 35$


Intensiteti i rrezikut prej 35, vlerësohet sipas kësaj matrice si Intensitet i mesëm



6.1 Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut

Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut të korrupsionit dhe formave të tjera të dëmtimit të integritetit, vlerësohet nga 1 në 100, si në tabelën e mëposhtme:

Ulët	Mesatar	Lartë
1 - 15 pikë	16 - 48	49 - 100

 Rreziku me intensitet të ulët – mundësia e ndodhjes së korrupsionit ose formave tjera të dëmtimit të integritetit është shumë e vogël për shkak të masave ekzistuese të kontrollit

 Rreziku me intensitet të mesëm – ndodhja e korrupsionit ose e formave tjera të dëmtimit të integritetit është e mundur, por masat e kontrollit menaxhojnë këtë rrezik.

 Rreziku me intensitet të lartë - Korrupsioni ose format e tjera të dëmtimit të integritetit janë tashmë të pranishme në këtë proces ose ka të ngjarë të ndodhin.

7. Fushat e rrezikut

7.1 Fushat e përgjithshme të rrezikut

Si fusha të përgjithshme të rrezikut gjatë hartimit të këtij plani të integritetit, e të cilat janë paraqitur edhe në Shtojcën 1 më poshtë, e cila është pjesë integrale e këtij plani janë.

- 7.2.1. Politikat e burimeve njerëzore
- 7.2.2. Planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit
- 7.2.3. Prokurimi publik
- 7.2.4. Auditimi i brendshëm
- 7.2.5. Ruajtja dhe sigurimi i dokumentacionit
- 7.2.6. Komunikimi me palë të jashtme të interesit

Fushat e përgjithshme të rrezikut janë identifikuar edhe përmes pyetësorit dhe në punën e përditshme të ZRRE-së, ku në Shtojcën 1 janë paraqitur hapat dhe afatet e përafërta për përmbushjen e tyre.



7.2 Fushat e veçanta të rrezikut

Si fusha të veçanta të rrezikut gjatë hartimit të këtij plani të integritetit, e të cilat janë paraqitur edhe në Shtojcën 2 më poshtë, e cila është pjesë integrale e këtij plani janë:

- 7.2.1. Çmimet dhe tarifat e energjisë elektrike dhe termike
- 7.2.2. Licencimi dhe autorizimet
- 7.2.3. Tregu i energjisë / konkurrenca
- 7.2.4. Konsumatorët

Sikurse fushat e përgjithshme të rrezikut edhe fushat e veçanta të rrezikut janë identifikuar edhe përmes pyetësorit, ku në Shtojcën 2 janë paraqitur hapat dhe afatet e përafërta për përmbushjen e tyre.

8. Miratimi dhe Hyrja në fuqi

Koordinatori/kryesuesi i grupit punues i caktuar me vendim të Bordit të ZRRE-së i prezanton Planin e Integritetit Bordit të ZRRE-së me propozimin për miratim. Pas shqyrtimit dhe adresimit të vërejtjeve eventuale, Bordi nënshkruan miratimin e Planit.

Vendimi për miratimin e Planit të Integritetit i dorëzohet Agjencisë për Parandalim të Korrupsionit, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga data e miratimit me Vendim nga Bordi Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe i njëjti hyn në fuqi datën e miratimit nga Bordi.

Kryesuesi i Bordit ose Drejtori Menaxhues njofton punonjësit për miratimin e planit të integritetit.



SHTOJCA 1. MATRICA E VLERËSIMIT TË RREZIKUT PËR FUSHA TË PËRGJITHSHME

FUSHAT E PËRGJITHSHME TË RREZIKUT									
Identifikimi i rrezikut		Intensiteti i rrezikut			Masat ndaj rrezikut			Masat ndaj rrezikut	
Nr	Fusha e rrezikut	Përshkrimi i rrezikut	Masat ekzistuese	Gjasat	Ndikimi	Intensiteti	Masat e propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rrezeqeve	Departamenti/Zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit
I.	POLITIKA E BURIMEVE NJERËZORE	Përditësimi i përshkrimeve të vendeve të punës. Procedurat e brendshme të rekrutimit nuk janë mjaftueshëm të detajuara për përzgjedhje dhe rekrutim të stafit.	Ligjet dhe aktet nënligjore ; Manuali i operimeve; Kodi i etikës	3	4	1,2	Rishikimi dhe përditësimi i përshkrimeve të punës; Përfshirja e detyrave shtesë në përshkrimet e punës; Rishikimi i formularëve të vlerësimit të performancës.	Njësia e Administratës (NJA)	Tetor 2024
				2	3	6	Procedurat të harmonizohen në detaje me aktet ligjore në fuqi.	NJA	Dhjetor 2024



POLITIKA E BURIMEVE NJERËZORE	Kapacitete dhe burime njerëzore të kufizuara lidhur me rregullativën e miratuar për etikë dhe integritet.			5	4	13	Organizimi i trajnimeve nga NJA me qëllim njohjen e punonjësve me Kodin e Etikës dhe Rregulloret e brendshme; Pjesëmarrja e punonjësve në trajnimet e organizuara nga IKAP ose AKK për etikën dhe integritetin.	NJA	Shtator 2024
	Mungesa e trajnimeve për sinjalizim dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.			7	3	6	Pjesëmarrja e punonjësve të ZRRE-së në trajnimet e organizuara nga AKK mbi sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.	Zyrtari përgjegjës për sinjalizim	Dhjetor 2024
	Mosplotësimi i vendeve të punës me staf adekuat dhe të mjaftueshëm.			5	5	25	Hartimi i Planit të Personelit. Miratimi i planit të personelit. Zbatimi i planit dhe punësimi i personelit adekuat dhe të mjaftueshëm.	NJA (burimeve njerëzore) Bordi i ZRRE-së Bordi i ZRRE-së	Dhjetor 2024 Dhjetor 2024 Dhjetor 2024



II.	PLANIFIKIMI DHE MENAXHIMI I BUXHETIT	Planifikimi i buxhetit vjetor të ZRRE-së	Ligjet, aktet nënligjore dhe aktet e brendshme	1	2	4	Raportim i rregullt për shpenzimet buxhetore dhe realizimin e buxhetit.	Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF)	Qershor 2024
		Inventarizimi dhe regjistrimi e-pasuri.		3	4	12	Të përditësohet regjistri i brendshëm i asetëve të ZRRE-së.	Zyrtar i pasurive	Qershor 2024
III.	PROKURIMI PUBLIK	Mungesa e trajnimit të Menaxhimit të Kontratave.	Ligjet, aktet nënligjore dhe aktet e brendshme	2	2	4	Trajnimi i personelit për menaxhimin e kontratave dhe çështje tjera në lidhje me prokurimin.	Menaxheri i Prokurimit	Shtator 2024
		Vështirësitë në mungesë të personelit adekuat të Përgatitjeve të specifikave të tenderit.		3	3	9	Rritja e kapaciteteve për përgatitjen e specifikimeve të tenderit.	Menaxheri i Prokurimit	Dhjetor 2024/2026
IV.	RUAJTJA DHE SIGURIMI I DOKUMENTACIONIT	Mungesa e procedurave të detajuara standarde të veprimit për arkivimin e dokumentacionit.	Ligjet, aktet nënligjore dhe aktet e brendshme	3	3	9	Zhvillimi i procedurës së punës për trajtimin e dokumentacionit zyrtar. Miratimi i kësaj procedure.	Njësia e Administratës	Shtator 2024



	Mungesa e pjesërishme infrastrukturës për arkivë dhe protokol	Mungesa e partneritetit me shoqërinë civile në lidhje me fushën e energjisë dhe bashkëpunimit me komunitetin e bizneseve.	brendshme	3	4	17	Sigurimi i infrastrukturës së nevojshme për protokol dhe arkivë.	Njësia e Administratës Bordi i ZRRE-së	Shtator 2024
V. KOMUNIKIMI ME PALË TË JASHTME TË INTERESIT		Mungesa e partneritetit me shoqërinë civile në lidhje me fushën e energjisë dhe bashkëpunimit me komunitetin e bizneseve.		3	3	6	Të rritet transparencja edhe më tutje për konsultime me palë të jashtme të interesit gjatë hartimit të rregullave (inicimi i diskutimeve publike, fokus grupe etj).	Zyrtari për Marrëdhënie me Publikun	Në vazhdimësi
	Mungesa e mbështetjes profesionale në fushën e komunikimit dhe informimit.				2	3	6	Pjesëmarrja në trajnime dhe hartimi, sigurimi i zbatimit të planeve të komunikimit.	Zyrtari për Marrëdhënie me Publikun Bordi i ZRRE-së



SHTOICA 2 . MATRICA E VLERËSIMIT TË RREZIKUT PËR FUSHA TË VEÇANTA

Fushat e veçanta të rrezikut						
Identifikimi i rrezikut		Intensiteti i rrezikut			Masat ndaj rrezikut	
Fusha e rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve
I. ÇMIMET DHE TARIKAT E ENERGJISË ELEKTRIKE DHE TERMIKE	Stafi i pamjaftueshëm në departament për përgatitjen e dokumenteve të nevojshme.	Ligjet, aktet nënligjore dhe aktet e brendshme	3	4	12	Të rekrutohet staf sipas strukturës organizative për departamentin dhe të ZRRE-së.
II. LICENCIMI DHE AUTORIZIMET	Stafi i pamjaftueshëm për përgatitje të akteve të nevojshme ligjore dhe monitorim të të licencuarve.		3	4	12	Të rekrutohet staf sipas strukturës organizative në mënyrë që të kryhen monitorime të vazhdueshme të të licencuarve.



III	TREGU I ENERGISJË DHE KONKURRENCA	Stafi i pamjaftueshëm në departament për përgatitjen e dokumenteve të nevojshme.	Ligjet, aktet nënligjore dhe aktet e brendshme	3	4	12	Të rekrutohet staf sipas strukturës organizative për të arritur objektivat e departamentit dhe të ZRRE-së.	Bordi i ZRRE-së	Dhjetor 2024
IV	KONSUMATORËT	Stafi i pamjaftueshëm në departament për përgatitjen e dokumenteve të nevojshme dhe përfaqësimin në Gjykata.	Ligjet, aktet nënligjore dhe aktet e brendshme	3	4	12	Të rekrutohet staf sipas strukturës organizative për të arritur objektivat e departamentit dhe të ZRRE-së.	Bordi i ZRRE-së	Dhjetor 2024